



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 85

Prishtinë: 16.05.2024, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Fridon Lala, Driton Hyseni, Agon Batusha Shqipe Isufi, Alban Bajrami dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Elmi Reçica dhe Blerta Deliu-Kodra.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi: Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit

Kryetarja e komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 19.04.2024 dhe 25.04.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-267 për letërnjoftimin, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-261 për mbrojtje nga zjarri, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-274 për shërbimet private të sigurisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-256 për falimentimin, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Para se të miratohej rendi i ditës, deputetja Fjolla Ujkani propozoi që të shtohet edhe një pikë, Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L- 298 për ratifikim e “Amendamentit nr.1 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2020”.

Komisioni e miratoi propozimin e deputetes Ujkani dhe rendi i ditës u miratua i plotësuar edhe me një pikë shtesë.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 19.04.2024 dhe 25.04.2024

Procesverbalet e dt. 19.04.2024 dhe 25.04.2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-267 për letërnjoftimin, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, tha se ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e kushteve, procedurave dhe organin kompetent për lëshimin, përdorimin e letërnjoftimit, si dhe detyrimet e shtetasit të Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë projektligj kemi edhe amendamentet e Komisioni funksional, ndërsa, sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, ky projektligj është pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.08/L-267 për letërnjoftimin, me amendamentet e Komisionit funksional është pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-261 për mbrojtje nga zjarri, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, tha se qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i mekanizmave dhe sistemit të mbrojtjes nga zjarri, duke përfshirë edhe shpërthimet me qëllim të mbrojtjes së jetës së njerëzve, kafshëve, pasurisë dhe mjedisit, sa i përket përafrimit me legjislacionin e BE-së, ky projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacion të BE-së.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.08/L-261 për mbrojtje nga zjarri, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja, tha se qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i misionit, organizimit, autorizimet dhe detyrat e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Lidhur me këtë projektligj kemi edhe amendamentet e Komisionit funksional, ndërsa, sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, njoftoi se ky projektligj nuk transponon legjislacion të BE-së, pra, mbetet kompetencë e brendshme e secilit shtet.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-274 për shërbimet private të sigurisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, tha se ky projektligj ka për qëllim të rregullojë kushtet, procedurat, aktivitetet dhe veprimtarinë e personave juridikë dhe fizikë që ofrojnë shërbime dhe aktivitete në fushën private të sigurisë dhe Projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë :

Përfundim

Projektligji nr.08/L-274 për shërbimet private të sigurisë, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-256 për falimentimin, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, tha se ky ligj rregullon dhe përcakton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me falimentimin, përkatësisht riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare, licencimin e administratorëve falimentues si dhe procedurën e falimentimit të shoqërive tregtare. Ky projektligj me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë :

Përfundim

Projektligji nr.08/L-256 për falimentimin, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L- 298 për ratifikim e “Amendamentit nr.1 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2020”

Kryetarja, tha se pasi kemi pranuar dokumentet lidhur me këtë projektligj, kam kërkuar nga stafi mbështetës i Komisionit, që të ftohet zëvendëskryeministri Bislimi më datën 18 prill 2024, për të raportuar në Komision dhe në të njëjtën kohë për të shqyrtuar këtë projektligj dhe Programin Kombëtar për Integrim Evropian, në mënyrë që të procedojmë për miratim në seancë.

Nga Kabineti i tij jemi njoftuar se në datën e propozuar, ai është në udhëtim zyrtar dhe se do na njoftonin se kur do të mund të bëhej ky prezantim, por deri më tani ne s’kemi pranuar asnjë datë për këtë prezantim.

Pra, Komisioni ynë është ngarkuar si Komision funksional për shqyrtimin e këtij projektligji i cili projektligj ka për qëllim amendamentimin e marrëveshjes IPA 2020, me qëllim të shtyrjes për 2 vite të afatit për zbatimin e marrëveshjes për të siguruar zbatimin e suksesshëm të projekteve që janë ballafaquar me vonesa, po ashtu, rialokimet e brendshme si dhe ndryshimet e modaliteteve të zbatimit.

Bazuar në dokumentet përcjellëse kjo marrëveshje nuk ka detyrime financiare nga Republika e Kosovës, meqenëse të gjitha fondet jepen nga Bashkimi Evropian.

Hapi debatin dhe e hodhi në votim Projektligjin

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë :

Përfundim

Miratohet Projektligji për ratifikim e “Amendamentit nr.1 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2020”

9. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi Komisionin se me datë 22 maj 2024, me fillim nga ora 09:00, në Hotelin “Sirius” do të mbahet tryeza e diskutimit e organizuar nga komisioni ynë.

Në këtë tryezë do të marrin pjesë përfaqësues nga sekretariat i CEFTA-s, RCC-ja, Ambasadori gjerman dhe ai i Zyrës së BE-së në Kosovë si dhe përfaqësues të institucioneve tona.

Po ashtu, janë ftuar një numër i madh i përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit

Rrezarta Krasniqi
Kryetare e Komisionit